

## Ligji mbi kujdesin shëndetësor dhe mjekësor thotë që:

Personeli mjekësor duhet t'i vërej fëmijët që janë të afërm, si dhe nevojat e tyre për informacion, këshilla dhe mbështetje, kur prindi i fëmijës, ose ndonjë person tjetër i rritur, me të cilin banojnë përherë së bashku, vdes ose ka:

- një sëmundje ose një lëndim serioz fizik
- sëmundje psikike ose zvogëlim funksioni
- shpërdorim ose sëmundje varësie
- ushtruar dhunë ndaj fëmijës ose ndaj një të afërmi të fëmijës

Në Rajonin Skåne, në të njëjtën mënyrë, duhet të vërehet fëmija, nëse një vëlla/motër, ka probleme shëndetësore të lartë përmendura.

## Lute ju lutem personelin e kujdesit për ndihmë

Nëse ke mendime, se si do të flasësh me fëmijët, se çfarë fjalësh do të përdorësh, çfarë informacioni ti do të japësh, atëherë personeli i kujdesit mund të jep mbështetje.



Fëmijët si të afërm  
Rajoni Skåne

## Uebfaqet për lexim të mëtutjeshëm në suedisht, për fëmijë që janë të afërm:

Udhërrëfyes i kujdesit [1177.se](http://1177.se)

- Pjesa, kur jeta familjare është e vështirë
- Pjesa, të ndjehesh keq si prind
- Kur një i rritur në familjen tënde, nuk ndjehet mirë

Qendra kombëtare e aftësisimit për të afërmit (NKA) [Fëmijët si të afërm. Qendra kombëtare e aftësive, të afërmit \(anhoriga.se\)](#)

Vend për t'i shënuar të dhënat e kontaktit:

---

---

---


---

---

## Kur ka fëmijë të mitur dhe të rinj në familje

Fëmijët ndikohen kur prindërit, vëllezër/motra ose dikush tjetër në familje është i sëmurë ose ka ndonjë funksion të zvogëluar. Edhe një fëmijë i vogël, e ndjen se diçka nuk është në rregull.

Fëmijët kanë nevojë të bëhen pjesëmarrës dhe të dinë, se çfarë po ndodhë në familje. Është me rëndësi të flitet me fëmijën për gjendjen e familjes, që mos të shqetësohet fëmija dhe të fantazoi vetëm.



## Fëmijët duan të dinë

Fëmijët bëhen pjesëmarrës, duke marrë informacion në mënyrë të ndryshme, duke u nisur nga mosha dhe nga pjekuria dhe duke u bërë pjesëmarrës dhe duke pasur mundësi të flasësh se si funksionon familja.

Inkurajo fëmijën të vij me ty në vizita në kujdesin, nëse fëmija e dëshiron këtë gjë. Parapërgatite duke i treguar mbi mjedisin e kujdesit. Fëmijët dëshirojnë ndonjëherë të dërgojnë diçka në njësinë pranuese të kujdesit në spital, p.sh. një ari kukull ose një vizatim.

## Të flasësh me fëmijën

Një mënyrë e mirë është, së pari, të dish se çfarë din fëmija, për gjendjen e anëtarit të familjes dhe rreth asaj, se çfarë po ndodhë. Lëre fëmijën të thotë mendimin e vet, duke treguar, se si ndjehet kur bën pyetje. Provo t'i përgjigjesh sinqerisht në pyetje. Nëse ti nuk e din përgjigjen, thuaj nuk e di.

Një pjesë e fëmijëve nuk pyesin gjë, por kjo nuk do të thotë që ata nuk kanë gjë për të pyetur. Fëmijëve mund të ju duhet kohë dhe pyetjet ndonjëherë mund të vijnë më vonë. Pyet me dëshirë, *çfarë* pyetjesh ka për të bërë fëmija, në vend që të pyesësh, *nëse* fëmija ka ndonjë pyetje për të bë. Fëmijët duhet nxitur që ata të *shkruajnë* pyetjet e tyre në letër.

Cilat pyetje ke për të bërë?

**Një pjesë e fëmijëve ndjehen fajtor për atë se çfarë ndodhë. Është me rëndësi t'u sqarohet fëmijëve, që sëmundja ose gjendja e anëtarit të familjes, nuk është faji i fëmijës!**

Nëse ka më shumë fëmijë në familje, është mirë të kesh parasysh e të flasësh, ashtu që edhe fëmijët e vegjël të kuptojnë. Ndonjëherë mund të ketë nevojë për biseda individuale, duke u nisur nga mosha dhe nevoja që ka fëmija.

Ki kujdes, sa mundet fëmija. Jepi mundësi, për biseda të ripërsëritura dhe për informacion.

## Çfarë mund të lehtësojë të zakonshmen?

Mundohu t'i ruash rutinat dhe interesimin e fëmijës, në të zakonshmen, aq sa është e mundur. Të jesh në parashkollë ose në shkollë, të vazhdosësh me aktivitete, të takosh shokë dhe të bësh gjëra të këndshme, është zakonisht mirë për fëmijën.

Ka, po ashtu, mundësi të kesh mbështetje nga kujdesi, shëndeti i nxënësit ose nga komuna, kur ngarkesa në familje bëhet e madhe. Informo me dëshirë dikë në parashkollë ose në shkollë e fëmijës, për të cilin person fëmija ka besim në të, mbi gjendjen aktuale në familje.

Një pjesë e fëmijëve marrin përsipër përgjegjësi të madhe për të rriturin dhe për anëtarët e tjerë të familjes. Mund të jetë një përgjegjësi e madhe dhe është e rëndësishme të lirohet fëmija nga kjo përgjegjësi. Përndryshe, kjo mund të ndikoj negativisht në shëndetin dhe në zhvillimin e fëmijës.

## Reagimet e fëmijës

Të gjithë njerëzit janë të ndryshëm, pra edhe fëmijët, prandaj fëmijët mund të reagojnë në mënyra të ndryshme, kur ata marrin informacionin për sëmundjen e anëtarit të familjes ose për zvogëlimin e funksionit.

Një pjesë e fëmijëve mërzhiten, të tjerët fëmijë nuk reagojnë fare. Reagimet pasqyrojnë shpesh nivelin e zhvillimit të fëmijës. Përveç kësaj, i njëjti fëmijë mund të reagoi ndryshe, në raste të ndryshme. Disa fëmijë reagojnë, duke qenë të

heshtur dhe pasiv, të tjerët bëhen agresiv dhe të zemëruar. Reagimet e ndryshme, nuk duhet të ju shqetësojnë, nënkuptuar që fëmija duket se është mirë. Mos ngurro të kërkosh ndihmë profesionale, nëse ti shqetësohesh për fëmijën tënd.

## Nëse fëmija ndjehet keq

Fëmijët të cilët ndjehen keq psikikisht, mund të shfaqin ndryshim të sjelljes dhe simptoma të ndryshme, më shpesh ripërsëriten. p.sh:

- dhembje të barkut
- dhembje koke
- dhembje të muskujve
- vështirësi përqendrimi
- çrregullim të gjumit
- problem në parashkollë ose në shkollë

**Shembull i veprimtarive për të kontaktuar, për moshat e ndryshme:**

Fëmijë 0–5 vjeç:

- QSHF – Qendra shëndetësore për fëmijë
- Veprimtaria e psikologut pranë njësisë pranuese të mamisë dhe QSHF
- Qendra shëndetësore
- Shërbimi social (kërkesë dhe mbështetje)

Fëmijë dhe të rinj 6–17 vjeç:

- Shëndeti i nxënësit – Kujdesi shëndetësor i shkollës
- Qendra shëndetësore
- Njësia pranuese për të rinj (12-23 vjeç)
- Një rrugë brenda, këshilla përmes telefonit për fëmijët dhe të rinjtë në Skåne, kur bëhet fjalë për mos-shëndetin psikik. Prindërit, por edhe fëmijët mund të telefonojnë atje. Numri i telefonit: 020-51 20 20
- Shërbimi social (kërkesë dhe mbështetje)